



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

MINISTRI



Nr. E-348/Prot. 2

Tiranë, më 10.09 2024

URDHËR

Nr. 433, Datë 10.09.2024

“PËR NDËRPRERJEN E FUNKSIONIT TË ANËTARIT TË KOMISIONIT DISIPLINOR TË PËRMBARUESVE GJYQËSOR PRIVAT TË Z. ERIND MËRKURI”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 2, të Ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të shkronjës “b”, të pikës 1, dhe të pikave 2, 7 dhe 9, të nenit 73 të ligjit nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”, si dhe të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr. 197, datë 26.06.2020 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për anëtar të Komisionit Disiplinor të Përmbartuesve Gjyqësor Privat”,

KONSTATOJ:

Me Urdhrin nr. 399 datë 26.11.2020 “Për zgjedhjen e anëtarit të Komisionit Disiplinor të Përmbartuesve Gjyqësor Privat”, z. Erind Mërkuri është zgjedhur anëtar i Komisionit Disiplinor të Përmbartuesve Gjyqësor Privat. Mandati si anëtar i Komisionit Disiplinor të Përmbartuesve Gjyqësor Privat i ka filluar me datë 01.12.2020, me afat përfundimi në datë 30.11.2024.

Me shkresën e protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. E-348 prot., datë 23.07.2024, z. Erind Mërkuri ka njoftuar dorëheqjen me arsyetimin se meqenëse si përfaqësues i shoqërisë civile, nga hedhja e shortit është vendosur që emri i tij t’i propozohet seancës plenare të Kuvendit, për t’u zgjedhur si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Referuar Vendimit nr. 69/2024 “Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatëve sipas ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, botuar në fletoren zyrtare nr. 129, datë 26.07.2024, z. Erind Mërkuri është zgjedhur Anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 2, të Ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”,

të ndryshuar, të shkronjës “b”, të pikës 1, dhe të pikave 2, 7 dhe 9, të nenit 73 të ligjit nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”, si dhe të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr. 197, datë 26.06.2020 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për anëtar të Komisionit Disiplinor të Përmbartuesve Gjyqësor Privat”,

URDHËROJ:

1. Ndërprerjen e funksionit si anëtar i Komisionit Disiplinor të Përmbartuesve Gjyqësor Privat të z. Erind Mërkuri.
2. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave dhe njoftimin e këtij Urdhri, z. Erind Mërkuri, Dhomës Kombëtare të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë si dhe Shkollës së Magjistraturës.
3. Ky Urdhër publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

